

Qasje me bazë risku ndaj shqyrtimit të pasqyrave financiare dhe përdorimit të informacionit financiar të audituar sipas SNRF-ve

Autori Michael Well

13-14 dhjetor 2021

PËRTIDËSIMI I RREGULLATORËVE ME SNRF-TË

CFRR >>>

**Centre for Financial
Reporting Reform**




STAREP

Strengthening Auditing and Reporting in
the Countries of the Eastern Partnership




Road to Europe: Program of Accounting Reform
and Institutional Strengthening

This event is co-funded by:

 Austrian
Development Cooperation

 **BMF**
FEDERAL MINISTRY
OF FINANCE

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



European
Union

 LE GOUVERNEMENT
DU GRAND-DUCHÉ DE LUXEMBOURG
Ministère des Finances



Vështrim i përgjithshëm

- » Qasje me bazë risku ndaj shqyrtimit të pasqyrave financiare sipas SNRF-ve
- » Publikimi i Bankës Botërore që informon interpretimin e Pasqyrave Financiare sipas SNRF-ve: udhëzues për mbikëqyrësit bankarë dhe financiarë
- » Diskutim në panel: shkëmbimi i përvojës ndërkombëtare



Qasje me bazë risku ndaj shqyrtimit të pasqyrave financiare sipas SNRF-ve

Mendimeet e shprehura në këtë prezantim janë të miat dhe jo domosdoshmërisht janë të ndonjë organizate me të cilin jam i lidhur.

Përse duhet përdorur një qasje me bazë risku për rishikimin e pasqyrave financiare sipas SNRF-ve?

- » **Qëllimi:** përdorimi efikas i burimeve të pakta për arritjen e rezultateve më të efektshme të rishikimit.
- » **Problemi i procesit:** Shqyrtimi përmes shënjitimit të kutive në informacionet shpjeguese – apo sipas në liste të pasqyrave financiare për përputhshmëri nuk ka të ngjarë të jetë i efektshëm në vlerësimin e cilësisë së kontabilizimit dhe raportimit sepse informacioni i përgjithshëm/standard fsheh mospërputhjet.
 - » Keqpërdorimi i listës me detyra për sa u takon informacioneve shpjeguese ‘4 të mëdhenjtë’ të pasqyrave financiare ilustruese.
 - » Rrjedhimisht, në sipërfaqe shpesh informacionet shpjeguese duken të pajtueshme.
 - » Por, ato jo pa tjetër japin gjykimet dhe çmuarjet e duhura.
- » Për më tepër, metoda e shqyrtimit në bazë risku me gjasa do të përqendohet në çështje më me rëndësi, për shembull, në identifikimin dhe analizën e:
 - » Gjykimeve më të rëndësishme të çdo njësie ekonomike; dhe
 - » Çështjeve të përzgjedhura që janë shqetësuese në atë kohë për rregullatorët.

Përse jo një qasje me listë kontrolli të informacioneve shpjeguese?

Shëmnull, amortizimi

Qasje me listë kontrolli ndaj informacioneve shpjeguese	Referenca	Testi
Përdorimi i metodës së amortizimit	IAS 16.73(b)	✓
Jeta e dobishme apo shkalla e amortizimit të përdorur	IAS 16.73(c)	✓
Vlera kontabël bruto në pasqyrën financiare dhe amortizimi i akumuluar (shtuar me humbjet e akumuluar të zhvlerësimit) në fillim dhe fund të periudhës.	IAS 16.73(d)	✓
Amortizimi për periudhën	IAS 16.73(e)(vii)	✓
Natyra dhe efekti i një ndryshimi në një çmuarje kontabël, duke përfshirë (a) vlerat e mbetura; (b) kostot e çmontimit, etj; (c) jetën e dobishme; dhe (d) metodat e amortizimit	IAS 16.76 lexuar me IAS 8	✓ procedura në informacionin shpjegues të politikës kontabël (nuk shihet ndonjë ndryshim)

Përse jo një qasje me listë me detyra lidhur me informacionet shpjeguese? Shembull, amortizimi (vazhdon)

**Qasja me listë detyrash për informacionet shpjeguese:
nxiste informacionin shpjegues (për AAM-të që ka gjasa të mos amortizohen më shumë)**

Referenca

Testi

Shuma kontabël neto në pasqyrë financiare e AAM-ve përkohësisht jo në përdorim dhe shuma në pasqyrat e AAP-ve që nuk përdoren më në mënyrë aktive dhe të paklasifikuara si të mbajtura për shitje në përputhje me SNRF 5

IAS 16.79(a)
dhe (c)

Supozoni se nuk zbatohet dhe nuk shihni prova për të kundërton

Vlera kontabël bruto e çdo AAM-je të amortizuar në përdorim (inkurajonte informacionin shpjegues)

IAS 16.79(b)



Përfundimn: ✓ përmbushëse (shumë mirë)—njësia ekonomike i ofron të gjitha informacionet e detyrueshme

Problem: mospajtim me parimin e amortizimit mund të ekzistojë sepse gjykimet e dhëna nga drejtuesit gjatë zbatimit të parimit të amortizimit mund të mos pasqyrojnë me besnikëri konsumin e potencialit të një artikulli për shërbim në periudhën e raportimit.



Qasja me bazë risku ndaj shqyrtimit të pasqyrave financiare sipas SNRF-ve

- » Çfarë të shqyrtosh?
 - » Kampionim me bazë risku, p.sh., industrinë me risk sistemik, industrinë me risk akut, sinjalizuesit, etj.
 - » Elementin e kampionimit të rastësishëm me qëllim që potencialisht të përfshihet e gjithë popullsia çdo vit.
 - » Çdo shoqëri të paktën çdo x vite (dmth., shpesh tësinë e fondeve rezervë)
- » Shqyrtimi gjithpërfshirëse, shqyrtime tematike, apo të dyja?
- » Mendësia e shqyrtimit të informacionit financiar sipas SNRF-ve
- » Protokolle të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve dhe mosmarrëveshjeve, një gamë veprimesh proporcionale, nga rikujtesat e sjellshme deri tek lëshimi i njoftimit të Disponueshme për Shitje (AFS) dhe kalimi i informacionit agjencive të tjera përkatëse.



Mendësia për shqyrtimin e informacionit financiar sipas SNRF-ve

» Qendrim i hapur, ushtrimi i skepticizmit profesional

- » Kuptoni stimujt e drejtuesve.
- » Shqyrtoni në mënyrë kritike gjykimet, çmuarjet dhe informacionet shpjeguese të riskut (jo duke shënuar kutitë!)
- » Tregoni kujdes për kontrollin e kualifikimeve dhe Çështjet Kyç të Auditit (ÇKA) POR mos u mbështesni tepër shumë në opinionin e auditit dhe letrat e drejtuesve.
- » A përputhen diskutimet dhe analizat e menaxhmentit (DAM) me të gatshme për shitje (AFS)?

» Mendësi hetuesi

- » Pritshmëri të informuara nga kuptimi i mjedisit ekonomik dhe të biznesit në nxjerrjen e pasqyrave financiare (dhe ngjarje pas bilancit, oreksi për risk i shoqërisë dhe drejtuesve).
- » Krahasoni politikat, gjykimet dhe rezultatet kontabël me shoqëri simotra.
- » Shqyrtoni gjetjet e rregullatorëve të tjerë në rrethana të ngjashme.
- » Kërkoni informacion: mbikëqyrësit, firmat e kontabilitetit, auditorët e jashtëm, komiteti i auditit.

Mendësia në rishikimin e gjykimeve dhe çmuarjeve të rëndësishme

Kuptoni llojet e kërkesave të SNRF-ve dhe mendësitë e gjykimeve të lidhur me to.

- » **Parimi** Hartat kontabël sa më pranë të dhënave për ekonominë e thjeshtë.
 - » Shembujt përfshijnë matjen e vlerës së drejtë dhe kontabilizimin e amortizimit; dhe riparaqitjen e krahasuesve për ndryshimet në politikat kontabël dhe për korigjimin e gabimeve të periudhës së mëparshme dhe
 - » A është mendësi gjykimi kritik të fokusuar kur kontabiliteti i njësisë ekonomike pasqyron ngushtësisht modelin ekonomik?
- » **Konstrukt artificial** kodifikimi i konvencioneve të vjetra (dhe ndonjëherë të sapokrijuara) që nuk korrespondojnë ngushtësisht me të dhënat për ekonominë e thjeshtë?
 - » I vështirë për t'u zbatuar në mënyrë konsekuente përveç kur përcaktohen rregulla të hollësishme për të informuar praktikën.
 - » Në mungesë të këtyre rregullave (siç ndodh ndonjëherë), BfC për një standard mund të jetë i dobishëm për të kuptuar atë që kërkon të kapë një konstrukt artificial (Paçi fat!)
- » **Rregulla specifike**: mendësia e ngurtësisë së verbër duke qenë se ka pak, apo aspak gjykim.

Shembull parimi i amortizimit

Parimi i amortizimit pasqyron modelin e konsumit të shërbimit potencial të zërit të amortizuar nga njësia ekonomike (IAS 16).

A ka ndonjë nga ndryshimet e mëposhtme: 1) ndryshim në politikën kontabël; 2) ndryshim në vlerësimin kontabël; 3) korrigjim i një gabimi të një periudhe të mëparshme; ose 4) varet

Problemi	IAS 8 dhe
Një ndryshim në metodën e amortizimit nga metoda e linjës lineare, në metodën e njësive të prodhimit.	IAS 16

Përshtatur nga Shtojca A në Paraqitja e Agjendës 11A Shqyrtimi i IAS 8 – Dallimi midis ndryshimeve në politikat kontabël dhe ndryshimeve në vlerësimet kontabël, takimi i majit 2015 i BNSK-së.

Në **02/2021** BNSK-ja nxorri *Përkufizimin e Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimi i SNK 8)* për të ndihmuar njësitë ekonomike të dallojnë ndryshimet në vlerësimet kontabël nga ndryshimet në politikat kontabël (data efektive = periudhat vjetore që fillojnë në atë datë apo më vonë).

Shëmbull matja e vlerës së drejtë *që zbaton parimin e matjes së vlerës së drejtë*

- » **Parimi** i matjes së vlerës së drejtë: çmimi me të cilin do të bëhej një transaksion i rregullt për të shitur aktivin apo për të transferuar detyrimin midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes në kushtet aktuale të tregut (pra, me çmimin e shitjes në datën e matjes nga perspektiva e pjesëmarrësit të tregut që mban aktivin apo zotëron detyrimin). (SNRF 13.2)
- » **Gjykimet** përfshijnë, a ka përdorur i regjistruari: (i) modelin e duhur? (ii) inputet e duhura të modelit? (iii) a ka marrë parasysh të gjithë faktorët që do të merrnin parasysh pjesëmarrësit e tregut në matjen e vlerës së drejtë? (iv) e ka përdorur modelin si duhet (pa gabime materiale)?

Shëmbull rregullator: FRC (UK) u kërkoi AngloEastern Plantations plc të riparaqitnin dy herë matjen e vlerës së drejtë të plantacioneve të veta të vajit të palmës!

Shembuj hierarkia e matjes së vlerës së drejtë që gjykon kufijtë e konstrukteve artificiale

Kufiri midis niveleve 1 & 2 transaksionet në treg ku tregtohet një artikull identik (dhe në të cilin njësia ekonomike mund të ketë qasje në datën e matjes), a zhvillohen me shpeshtësi dhe vëllim të mjaftueshëm për të dhënë informacion mbi çmimin në bazë të vazhdueshme? (SNRF 13. A)

Shembull rregullator – JSE (pas shqyrtimit të pasqyrave financiare të 2016 të borxhmarrësve) vëren:¹

- » Emetuesit e instrumentit të borxhit nuk i kishin klasifikuar si duhej instrumentet e tyre të borxhit në Nivelin 1, duke pasur parasysh pasivitetin e tregtisë në dëftesat e rregjistruara në bursë në tregun afrikano jugor të normës së interesit.
- » Edhe kur tregtia zhvillohet, zakonisht nuk bëhet me shpeshtësi dhe vëllim të mjaftueshëm për të përligjur klasifikimin në Nivelin 1.

Shembuj hierarkia e matjes së vlerës së drejtë që gjykon kufijtë e konstrukteve artificiale

Kufiri midis nivelit 2 dhe 3 – inute të rëndësishme që nuk vihen re?

Shembull, politikë specifike sipas njësisë ekonomike – HSBC (2020) pasqyrat financiare, f.292:

- » “Inute të rëndësishme të pa konstatueshme kur, për mendimin e drejtuesve, një përqindje e madhe e fitimit të instrumentit në fillim apo më shumë se 5% e vlerësimit të instrumentit varet nga inputet e pakonstatueshme.
- » ‘E pakonstatueshme’ në këtë kontekst do të thotë se ka pak apo aspak të dhëna aktuale për tregun në bazë të të cilave të përcaktohet çmimi me të cilin ka të ngjarë të bëhet një transaksion me kushte të barabarta. Përgjithësisht, nuk do të thotë se nuk ka të dhëna të disponueshme mbi të cilat të mbështetet përcaktimi i vlerës së drejtë (mund të përdoren, për shembull, të dhëna konsensuale për çmimin)”

Shembull rregullator – JSE (pas shqyrtimit të pasqyrave financiare të 2016) konstatoi:

- » Emetuesi i instrumentit të borxhit zotëronte prona investimi dhe gabimisht i kishte klasifikuar në Nivelin 2 të vlerës së drejtë kur nuk ka shumë gjasa që prona në tregun e Afrikës së Jugut t’i plotësojë kushtet e kriterit për klasifikim të vlerës së drejtë në nivelin 2 [L SEP]
- » Klasifikim jo i saktë i instrumenteve financiare operative (p.sh. Llogaritë klientë dhe furnitorë, pra, të arkëtueshmet dhe të pagueshmet, qiratë, huat e arkëtueshme dhe huatë e pagueshme sikur janë në nivelin 2 dhe jo në nivelin 3).

Shembull matje të vlerës së drejtë (vazhdon)

Nëse nuk është një korigjim i një periudhe të mëparshme, a janë sa më poshtë: 1) ndryshime të politikave kontabël; apo 2) ndryshime në vlerësimet kontabël?

Çështja	IAS 8 and
Një ndryshim në modelin e opsionit të çmimit për opsionet e aksioneve nga Black and Scholes për Monte Karlon.	SNRF 2
Ndryshim në vlerësimin e riskut të kredisë së vet për matjen e detyrimeve financiare me vlerën e drejtë; p.sh., duke përdorur lakoren e marrëveshjeve të këmbimit të riskut të kredisë dhe jo përdorimin e spredit të borxhit të emetuar së fundmi.	SNRF 13
Ndryshim në përlogaritjen e rregullimit të vlerës së kredisë (CVA) për të përcaktuar probabilitetin e mospagimit.	SNRF 13
Ndryshim në teknikën e vlerësimit për të matur vlerën e drejtë, për shembull, nga qasja në bazë tregu në qasjen në bazë të ardhurash (Niveli 3).	SNRF 13

Parimi i matjes së vlerës së drejtë: vlerësimi i çmimit me të cilin kryhet një transaksion i rregullt për të shitur aktivin apo transferuar detyrimin do të zhvillohej midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes sipas kushteve aktuale të tregut (pra, një çmim shitjeje në datën e matjes nga perspektiva e një pjesëmarrësi në treg që mban aktivin apo zotëron detyrimin). (SNRF 13.2)

Shembuj kostoja historike

Konstrukti artificial i koston historike. Kur nuk janë korigjime të një gabimi të një periudhe të shkuar a janë sa më poshtë: 1) ndryshime të politikave kontabël; apo 2) ndryshime në vlerësimet kontabël?

Çështja	IAS 8 dhe
Ndryshim në shpenzime përfshirë në matjen fillestare të aktiveve të kërkimit dhe vlerësimit.	SNRF 6
Ndryshim në formulën e koston së përdorur për inventarët: nga FIFO në koston mesatare të ponderuar.	IAS 2
Konstrukti artificial i koston historike: shuma e parave apo ekuivalenët e parave të paguar apo vlera e drejtë e të gjitha konsideratave të tjera, dhënë për blerjen e një aktivi në kohën e blerjes së tij apo ndërtimi, sipas rastit, shuma që i atribuohet atij aktivi kur njihet fillimisht në përputhje me kërkesat specifike të SNRF-ve të tjera, p.sh., e SNRF 2 për <i>Pagesën në bazë aksioni</i> (IAS 16.6) + konvencionet e përcaktuara në SNK 16.11 deri tek 16.28 + IFRIC, etj.	



Parimet e shqyrtimit në bazë risku të pasqyrave financiare sipas SNRF-ve

- 1 – Kuptoni mjedisin ekonomik
- 2 – Kuptoni njësinë e rregulluar ekonomike
- 3 – Përcaktoni fushat e fokusit
- 4 – Përdorni punën e të tjerëve
- 5 – Kuptoni kontabilitetin përkatës
- 6 – Studioni me kujdes gjykimet dhe çmuarjet e rëndësishme
- 7 – Hartoni çështjet që kërkon t'i hulumtoni
- 8 – Respektoni protokollet, praktikat dhe kodet.



**Publikim i stafit të Bankës Botërore
*që informon leximin e pasqyrave
financiare sipas SNRF-ve: Udhëzues
për mbikëqyrësit bankarë dhe
financiarë***

Publikim i stafit të Bankës Botërore që informon leximin e pasqyrave financiare sipas *SNRF-ve: udhëzues për mbikëqyrësit bankarë dhe financiarë*

Objektivi □ të ofrojë praktika dhe shembuj të sugjeruar të çështjeve specifike kontabël dhe çështje që mbikëqyrësit duhet t'i kenë parasysh në monitorimin dhe shqyrtimin e pasqyrave financiare të sektorit bankar.

- » Synon t'u mundësojë mbikëqyrësve prudencialë të kuptojnë nxitësit dhe risqet e biznesit të bankave dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike cilësinë e aktiveve financiare dhe dispozitat përkatëse për humbje nga kreditë duke përdorur pasqyrat financiare sipas SNRF-ve.
- » Liston fushat rregullatore të lidhura me kërkesat kontabël, të cilat mbikëqyrësit mund t'i hetojnë më tej kur shqyrtojnë pasqyrat financiare.
- » **Shtojcë** që përshkruan kërkesat kyç të SNRF 9, duke përfshirë praktikën e sugjeruar nga perspektiva e mbikëqyrjes prudenciale.
- » Nuk është një listë me detyra dhe nuk duhet përdorur si listë me detyra për përdorimin e qasjes së shënimit të kutive në të.



Publikim i stafit të Bankës Botërore që informon leximin e pasqyrave financiare sipas *SNRF-ve: udhëzues për mbikëqyrësit bankarë dhe financiarë*

Praktika të sugjeruara për t'u përdorur nga mbikëqyrësit në shqyrtimin e informacionit financiar sipas SNRF-ven:

- 1 – Kuptoni mjedisin ekonomik dhe të biznesit.
- 2 – Kuptoni strukturën e grupit bankar, modelin e biznesit dhe profilin e riskut.
- 3 – Identifikoni fushat ku duhet të fokusoheni (përfitoni nga puna e të tjerëve).
- 4 – Kuptoni kontabilitetin përkatës.
- 5 – Shqyrtoni politikat kontabël, gjykimet dhe vlerësimet e rëndësishme.
- 6 – Vini në pyetje rëndësinë dhe përshtatshmërinë e të dhënave dhe supozimeve të përdorura nga drejtuesit e lartë.
- 7 – Vlerësoni ndikimin e kërkesave kyçe të kontabilitetit në kapital dhe vijimësinë e njësisë ekonomike.



**Diskutim në panel: Shkëmbimi i
përvojës ndërkombëtare**

- » **Moderator: Garik Sergeyan** | Specialist i lartë i menaxhimit financiar, Banka Botërore
- » **Sonja Carshagen** | Specialiste e raportimit financiar, drejtorja e i rregullimit të emetuesve, Bursa e Johannesburgut
- » **David Grünberger** | Shef sektori, Banka Qendrore Evropiane
- » **Darrel Scott** | Konsulent, Banka Botërore
- » **Michael Wells** | Konsulent, Banka Botërore



Temat

Tema 1: objektivat dhe proceset

Tema 2: temat e përsëritura

Tema 3: produktet

Pyetje nga pjesëmarrësit në ngjarje